

PAGEZIMI

Diten e pare, qe l'int foshnja, Prifti e kryqesón lehonen dhe foshnjen, pastáj thote:

I bekuar eshte Perëndia ync, gjithenjé, taní e përhershë dhe në jetet e jéteve.

Shenjt Perëndí, Shenjt i fuqishim, Shenjt i pavdekur, meshirona (*3 here*).

Lavdí Atit e Birit edhe Shpirtit Shenjt, taní e përhershë dhe në jetet e jéteve. Amín.

Triní e tereshenje, meshirona; o Zot, hiresoji mëkatat tona; o Kryezót, fal-i paudhesite tona; o i Shenjte, veshtroji, dhe shëroji sëmundjet tona per emrin tent. Meshiró, o Zot (*3 here*).

Ati ync, qe je në qell, u-shenjterofte emri yt; arthte Mbreteria jote; u-beftë deshira jote si në qell edhe mi dhé; bukën tone të perdicime épna je neve sot; edhe fálnaji fajet, sikunder edhe në ua

falim fajtoreve tanë; edhe mos na shtjer në ngasjë, po shpetona nga i ligu.

Se jotja eshte Mbreteria dhe fuqia dhe lavdia, e Atit e Birit edhe Shpirtit Shenjt, taní, e përhershë dhe në jetet e jéteve.

Pastáj Prifti thote Uraten e Lindjes:

Le ti lútemi Zötit.

O Zot i terefuqishim, qe shérón çdo sëmundje dhe çdo lengate, ti shëroje dhe shërbetoren tende (*aksh*), qe lindi sot, dhe ngrer-e nga shtrati, ku eshte shtrire. Rúaje këtë dhe foshnjën, qe ka lindur; mbuloje nenc hien e flëtëve të tua qe sot e gjer në diten e funtme të saj; me nermjetimet e Shen Marisc dhe të gjithë Shenjtoreve; se ti je i bekuar në jetet e jéteve. Amín.

Kur deshtón nonjé lehone, Prifti thote Uraten e Deshimit:

Le ti lútemi Zötit.

O Zoti ync Jesú Krisht, qe linde prej Virgjeres Marí, dhe u-shtrive si foshnje në grazhdin e një shpelle, kij meshire per shërbetoren tende (*aksh*), qe ka deshtuar foshnjën, fal-i çdo faj të dashur dhe të padashur, ep-i shendetin, dhe ngrer-e nga shtrati, ku po dergjet, me nermjetimet e Shen Marisc dhe të gjithë Shenjtoreve. Amín.

Tete dite pas lindjes, foshnja sillet prej mamise ne Kishë per te emeruar. Prifti e kryqesón, dhe thote Uraten e Emerimit:

Le ti lútemi Zotit.

O Zot, o Perendia yne, ty te fálemi, dhe ty te lútemi: Le te shkelqenje drita e fytyres sate mi sherbetorin tent (*aksh*), dhe le te shenohet Kryqi i Krishtit ne zemren dhe ne mejtimet e tij, qe te baresc pas porrosive te tua; vleresoje te bashkohet me Kishen tende te shenjte, te bekohet me anen e Mistéreve te Krishtit, edhe te trashegonje lumrít' e Mbreterise qellore; me nermjetimet e Shen Marise dhe te gjithe Shenjtóreve. Amín.

Pastáj Prifti e merr foshnjen ne krahe, qendrón perpara Kores se Shen Marise, dhe ben shenjen e Kryqit, dyke thene:

Gëzohu o Hirplotë Hyjlíndese Virgjèreshe, se prej teje ka lindur Díelli i drejtësise, Krishti Perendia yne, qe ndrit ne erresire. Gëzohu edhe ti o plak i drejtë, qe prite ne peqinjte, çlirimtarin e shpírteve, i cili na dhurój Ngjalljen te gjithëve.

Me diten e dyzette, foshnja sillet ne Kishë prej nenes. Prifti e kryqesón, dhe thote Uraten e Dyzét Dítëve:

O Zot, o Perendí i terefuqishim, At i Zotit tonë Jesú Krisht, qe krijove tere natyren me anen e Fjales sate, qe i bcre te gjitha nga e paqëna, ty te fálemi dhe ty te lútemi; shpetoje sherbetoren tende (*aksh*), e cila vjen sot ne Kishen tende te shenjte; çliroje prej çdo mekat, fal-i çdo faj te dashur dhe te padashur, dhe vleresoje te kungonje Missteret e tua te shenjta.

Neqóftese foshnja ka vdekur, Urata kendohet gjer ke-

tú, pastáj Prifti thote:

Se ti je Perendí i mire dhe njeridashes, dhe ty te dergojme lavdí, Atit e Birit edhe Shpirtit Shenjt, taní e përhershë dhe ne jetët e jétéve. Amín.

Neqóftese foshnja rron, Prifti i ve doren mi koke, dhe thote:

Dhe foshnjën, qe ka lindur prej saj, bekoje, rrit-e, shenjtëroje, ndriçoje dhe nemeroje me grigjen tende te shenjte. Se ti, o Zot, i ruan foshnjat, edhe ty te dergojme lavdí, Atit e Birit edhe Shpirtit Shenjt, taní e përhershë dhe ne jetët e jétéve. Amín.

Pastáj Prifti e merr foshnjen ner krahët, ben shenjen e Kryqit perpara Deres se Bukur, dhe thote:

Kisherohet sherbatori i Perendise (*aksh*), me emrin e Atit e Birit edhe Shpirtit Shenjt. Amín.

Ne qofte djale, Prifti e shpie brenda ne Shenjteroren, dhe e rotullón reth Alltarit; ne qofte çupe, qendrón perpara Deres se Bukur; pastáj thote Troparin e Simeonit:

Taní perlëshoje sherbetorin tent, o Zot, me paqe pas fjales sate, se syt' e mi pane shpetimin tent, qe prebatite përpara faqes se gjithe pòpujve, drite per te ndriçuar paganët, edhe lavdí per pòpullin tent Israél.

Kur sillet dikúsh per te pagezuar, Prifti e çvesh, e zbath, e qendrón nga lindja, e kryqesón tri here, pastáj i ve doren mi koke, dhe thote Uraten e Katekumenit:

Me emrin tent, o Zot, e ve dorën mi sherbetorin tent (*aksh*), i cili u-vlerësua te perike nënë hien e

fléteve te tua. Largó prej tij rrejtjen e vjeter, dhe mbush-e me besen, me shpresen dhe me dashurine per ty, qe te mesonje se ti je i vétémi Perendí i vertete, dhe Biri yt i vetem, Zoti yne Jesú Krisht, edhe Shpirti Shenjt; çel-i syt' e mendjes, qe te shikonje driten e Ungjillit tent; prit-e ne Mbreterine qellore, dhe shpetoje nga zgjedha e armikut; shkrúaje ne libren e jetes, dhe bashkoje me grigjen tende; ep-i nje Engjell udhëheqes, qe ta rúanje, dhe ta drejtonje sipas porrosive te tua; shikoje gjithenjé me perdellim edhe meshire; dhe ngazelloje me veprat e dúarve te tij, qe ta lavderonje emrin tent madheshtór dhe te nderuar. Se ty te kendojne gjithe Forcat e qejve, dhe ty te dergojme lavdí, Atit e Birit edhe Shpirtit Shenjt, taní e pérherc dhe ne jetet e jéteve. Amín.

Pastáj Prifti e kthen Katekumenin nga perendimi me dúarte perpjete, dhe i ben tri here pyetjet pasónjese, dhe merr pergjigjet perkátese nga Katekumeni vete ose nga Nuni:

PRIFTI: A e mohón Satanin, dhe gjithe veprat e tij, dhe gjithe Engjet' e tij, dhe gjithe adhurimin e tij, dhe gjithe pompen e tij?

NUNI: E mohónj.

PRIFTI: A e mohove Satanin?

NUNI: E mohova.

PRIFTI: A bashkohesh me Krishtin?

NUNI: Bashkohem.

PRIFTI: A u-bashkove me Krishtin?

NUNI: U-bashkova.

PRIFTI: Dhe á e besón?

NUNI: E besónj si Mbret e Perendí.

Pastáj thuhet Simboli i Beses:

Besónj me nje Perendí, Atin e terefujishim, krijetarin e qellit e te dheut, e te gjithe te dükurave dhe te padükurave. Dhe me nje Zot Jesú Krisht, te vétémin Bir te Perendise, qe lindi prej Atit përpara gjithe jéteve. Drite prej Drite, Perendí te vertete prej Perendie te vertete, qe lindi, dhe nuk u-be, te bashkeqenshim me Atin, me anen e te cilit u-bene te gjitha. Qe per né njérezit edhe per shpetimin tone zbriti prej qellit, edhe u-misherua prej Shpirtit Shenjt edhe Virgjereshës Marí, dhe u-be njerí. Qe u-be kryqesua per né me kohen e Pontit Pilát, edhe vojti, dhe u-varrós. Dhe u-ngjall me te treten dite pas Shkónjave. Dhe u-ngjit ne qell, dhe ndenji me te djathтен e Atit, edhe do te vinje prape me lavdí te gjykonje te gjallet e te vdékurit, edhe Mbreteri' e tij do mos kete mbarím. Dhe me Shpirtin Shenjt, Zotin e jetebéresin, qe dergohet prej Atit, qe adhurohet, e lavdërohet me Atin e me Birin, qe foli me anen e Proféteve. Me nje Kisha te Shenjtë, te Pergjitheshme dhe Apostollore. Refénj nje Pagezim per ndjesen e mekátave. Pres ngalljen e tc vdékurve dhe jeten e botes qe vjen. Amín.

Pastáj Prifti e pyét perserí Katekumenin:

PRIFTI: A u-bashkove me Krishtin?

NUNI: U-bashkova.

PRIFTI: Falu, pra.

NUNI: I falem Atit e Birit edhe Shpirtit Shenjt, Trinise bashkekénshime dhe se pandare.

PRIFTI: I bekuar eshte Perendia, qe dó shpetimin dhe ndriçimin e gjithë njéresve, taní e perherë dhe ne jetet e jeteve.

KORI: Amín.

DHJAKU: Le ti lútemi Zotit.

PRIFTI: O Kryezót, o Perendia ync, thirr-e sherbetorin tent (*aksh*), dhe vleresoje per hirin e math te Pagezimit te shenjte. Çvesh-i vjetersine, perserit-e me jeten e ameshuar, mbush-e me fuqín' e Shpirtit Shenjt, bashkoje me Krishtin, dhe bej-e anetár te Mbretërisë sate. Me miredashjen dhe hirin e Birit te vetem, me te cilin je i bekuar, bashkë me Shpirtin e tereshenjte dhe te mire dhe jeteberes, taní e perherë dhe ne jetet e jeteve. Amín.

Pastaj Prifti hyn ne Shenjteroren, vishet me stoli prifterore te bardhe, del me Temjanicen, edhe temjanis Fon- tin reth e perqark, edhe nis Sherbesen e Pagezimit:

DHJAKU: Bekó, o Ate.

PRIFTI: E bekuar eshte Mbretëria e Atit e Birit edhe Shpirtit Shenjt, taní e perherë dhe ne jetet e jeteve.

KORI: Amín.

Pastaj thuhet Litania e Madhe:

DHJAKU: Me paqe le ti lútemi Zotit.

KORI: Meshiró, o Zot.

DHJAKU: Per paqen qe lártazi dhe per shpetimin e shpirteve tona, le ti lútemi Zotit.

KORI: Meshiró, o Zot.

DHJAKU: Per paqen e tere botes, per mirevajtjen e Kishëve te shenjta te Perendise dhe per bashkimin e te gjithave, le ti lútemi Zotit.

KORI: Meshiró, o Zot.

DHJAKU: Per keté Kishë te shenjte dhe per atá, qe hyjne ketú me besë, devotësë dhe frikë Perendie, le ti lútemi Zotit.

KORI: Meshiró, o Zot.

DHJAKU: Per Kryepeshkopin tone (*aksh*), per prifterine dhe dhjakérin' e nderuar me Krishtin, per tere klerin dhe pòpullin, le ti lútemi Zotit.

KORI: Meshiró, o Zot.

DHJAKU: Qe te shenjterohet kjo uje me fuqine, veperimin dhe permindodhjen e Shpirtit Shenjt, le ti lútemi Zotit.

KORI: Meshiró, o Zot.

DHJAKU: Qe te dergohet mi keté uje hiri i çperblimit edhe bekimi i Jordanit, le ti lútemi Zotit.

KORI: Meshiró, o Zot.

DHJAKU: Qe te zbresë mi keté uje veperimi paqesór i Trinise se permiqénshime, le ti lútemi Zotit.

KORI: Meshiró, o Zot.

DHJAKU: Qe te behet i vyer per Mbreterine qellore aý, qe do te pagezohet ne keté uje, le ti lútemi Zosit.

KORI: Meshiró, o Zot.

DHJAKU: Qe te behet bir i drites dhe trashegimtár i te mírave te ameshúara, le ti lútemi Zosit.

KORI: Meshiró, o Zot.

DHJAKU: Qe te behet anctár dhe pjesetár i vdekjes dhe i ngjalljes se Krishtit, Perendise sone, le ti lútemi Zosit.

KORI: Meshiró, o Zot.

DHJAKU: Qe te shpetojme prej çdo hidherimi, merie, reziku dhe nevoje, le ti lútemi Zosit.

KORI: Meshiró, o Zot.

DHJAKU: Perkrahna, shpetona, meshirona dhe rúajna, o Perendí, me hirin tent.

KORI: Meshiró, o Zot.

DHJAKU: Tercshenjten, te pacinúaren, te permibekúaren, te lavderúaren, Kryezonjen tone, Hyjlíndesen dhe gjithenjé Virgjereshen Marí dyke kujtar me gjithë Shenjtoret, veten tone dhe njerjatrin dhe tere jeten tone Krishtit Perendí le tja pranojme.

KORI: Ty, o Zot.

Pastáj Prifti thote Uraten e Ujit te Bekuar:

PRIFTI: I math je, o Zot, edhe te habíçime ja-

ne veprat e tua, dhe asnjé fjale nuk esht e mjaftë per te treguar çudirat e tua (*3 here*). Se ti i bëre të gjitha nga e paqena, ti e përbán kriesen me fuqine tende, ti e sundón botën me providencen tende. Se ti, o Perendia ync, u-çfaqe mi dhenc, dhe ushoqerove me njérezit; ti i shenjterohe valat e Jordanit, edhe i dermove koket e dragonjve, qe folesonin atjé. Ti, pra, o Mbret njeridashes, eja dhe taní me permindodhjen e Shpirtit Shenjt, edhe shenjteroje keté uje (*3 here*). Dhe jep-i hirin e çperblimit edhe bekimin e Jordanit. Le te dermohen nëne shenjen e Kryqit te çemuar gjithe fuqite kundershtare (*3 here*). Se ty te ka hie çdo lavdí, nder e adhurím, Atit e Birit edhe Shpirtit Shenjt, taní e perhere dhe ne jetet e jéteve.

KORI: Amín.

PRIFTI: Paqe te gjitheve.

KORI: Dhe me frymen tende.

PRIFTI: Kreret tona Zosit le tja unjim.

KORI: Ty, o Zot.

Pastáj Prifti e kryqesón enen e vajit, edhe thote Uraten e Vajit:

DHJAKU: Le ti lútemi Zosit.

KORI: Meshiró, o Zot.

PRIFTI: O Kryezót, o Perendí i Aterve tanë, qe i dergove Noes pullumbin me një degë ulliri, si shenje pajtimi dhe shpetimi nga permbytja, ti bekoje keté vaj me fuqine, veperimin dhe permindodhjen e Shpirtit Shenjt, per lavdine tende, dhe

te Birit te vetem edhe Shpirtit tereshenjtë dhe te mire dhe jetebëres, taní e përhershë dhe në jetët e jéteve.

KORI: Amín.

DHJAKU: Le te vëmë re.

Pastáj Prifti ben Kryqe me vajn mi ujen e Fontit, dyke kenduar:

PRIFTI: Alilluja, alilluja, alilluja.

KORI: Alilluja, alilluja, alilluja.

PRIFTI: I bekuar është Perendia, që i ndriçón dhe i shenjterón te gjithe njérezit, që vijnë në botë, taní e përhershë dhe në jetët e jéteve.

KORI: Amín.

Pastáj Prifti e lyen me vaj Katekumenin, dyke i bere shenja Kryqi mi ballën, kraherorin, veshet, kembet edhe dúarte, dyke thene:

PCR BALLËN: Lyhet shërbetori i Perendise (*aksh*) me vaj ngazellimi, me emrin e Atit e Birit edhe Shpirtit Shenjt. Amín.

PCR KRAHCRORIN: Që ti shërohet shpirti dhe trupi.

PCR VESHËT: Që ta degjonje besën.

PCR KËMBËT: Që te barese pas porrosive të tua.

PCR DUARTË: Dúart' e tua me bëne, dhe më gatuan.

Pastáj Prifti e pagezón, dyke e mbajtur nga lindja, dyke e kallur tri here ne uje, dhe dyke thene:

PRIFTI: Pagezohet shërbetori i Perendise (*aksh*), me emrin e Atit, amín; e Birit, amín; edhe Shpirtit Shenjt, amín.

Pastáj Prifti i lan dúarte, dhe e vesh te pagezúarin, dyke thene:

PRIFTI: Vishet shërbetori i Perendise (*aksh*) me këmishe drejtesie, me emrin e Atit e Birit edhe Shpirtit Shenjt. Amín.

Dhe kendohet ky Tropár me T. T. IV:

Këmishe të shkelqyer me dhuró, ti që je i vëshur me driten e diellit, Perendí i zëmerdhëmpshur, o Zoti Krisht.

Pastáj Prifti thote Uraten e Miro:

DHJAKU: Le ti lútëmi Zotit.

PRIFTI: I bekuar je, o Zot, o Perendí i terefufiqishim, që e përlinde shërbetorin tent (*aksh*) me anën e Pagezimit, edhe i dhurove ndjesën e mëkâtave të dáscura dhe të padáscura. Ti edhe taní, o Kryezót, o Mbret i gjithësisë, dhuroji edhe shilen e dhurates së Shpirtit Shenjt edhe kungaten e Trupit edhe Gjakut të çëmuar te Krishtit. Rúaje në shenjterimin tent, shiguroje në besën Orthodoxe, dhe bej-e bir dhe trashegimtár te Mbretërisë qellore. Se ti je Perendí i meshires edhe i shpetimit, edhe ty te dergojmë lavdí, Atit e Birit edhe Shpirtit Shenjt, taní e përhershë dhe në jetët e jéteve. Amín.

Pastáj Prifti e lyen te pagezúarin me Miron e Shenjte,

dyke i bere Kryqe mi ballen, syte, hunden, gojen, veshet, krahedorin, dúarte dhe kembet, edhe thote:

Shila e Dhurates se Shpirtit Shenjt. Amín.

Pastáj Prifti me Temjanicen, Nuni dhe i pagezúari rotullojne reth Fontit, dyke kenduar:

Sa u-pagezuan me Zotin Krisht, u-veshte me Zotin Krisht, alilluja (3 here).

Lavdí Atit e Birit edhe Shpirtit Shenjt, taní e perhere dhe ne jetet e jéteve. Amín. U-veshte me Zotin Krisht, alilluja.

Sa u-pagezuan me Zotin Krisht, u-veshte me Zotin Krisht, alilluja.

Pastáj kendohet Apostulli:

DHJAKU: Le te vème re.

KENDONJESI: Zoti eshte drita ime dhe shpetimi im. Zoti eshte forca e jetes sime.

DHJAKU: Urtesí.

KENDONJESI: Kendimi prej Letres se Palit per Romanet.

DHJAKU: Le te vème re.

KENDONJESI: Vellezer, sa u-pagezuan me Krishtin, me vdekjen e tij u-pagezuan. Se dyke u-pagezuar, vdiqme, dhe u-varrosmë, qe te ngríhemi me nje jete te perseritut ashtú, sikunder u-ngjall Krishti prej se vdékuresh me lavdín' e Atit. Se posa vdesim pas menyres se tij, gjithashtú do te ngjállemi si aý, dyke ditur se njeriu yne i vjetër u-kryqesua, qe te çduket trupi i me-

katit, dhe te mos i sherbejmc mëkatit më, se aý, qe vdiq, esht i çliruar prej mëkatit. Pra, posa vdiqme bashkë me Krishtin, besojme se edhe do te rrojme bashkë me até, dyke ditur qe Krishti, passi u-ngjall se vdékuresh, nuke vdes më, dhe vdekja nuk e zoterón më. Se kur vdiq nje here, vdiq per mekatin, po taní qe rron, po rron me Perrendine. Ashtú edhe ju e nemeroni veten tuaj te vdekur nga mekati dhe te gjalle nga Perendia, me Jesú Krishtin, Zotin tone.

KORI: Alilluja, alilluja, alilluja.

DHJAKU: Urtesí, o te drejtë. Le ta degjojmë Ungjillin e Shenjtë.

PRIFTI: Paqe te gjithëve.

KORI: Dhe me frymen tende.

PRIFTI: Kendimi prej Ungjillit te Shenjtë pas Mattheut.

DHJAKU: Le te vème re.

KORI: Lavdí me ty, o Zot, lavdí me ty.

DHJAKU: M' até kohe, te njembëdhjete Dishépujtë vajtin ne Galilé, ne malin ku i kishte porrositur Jesúj. Dhe kur e panc, iu-falnë, po ca dyshuan. Dhe u-aferua Jesúj, dhe u foli dyke thencë: Me eshte dhencë e tere fuqia mi qellin e mi dhencë. Eceni, pra, dhe nxenesójini gjithë kombet, dyke i pagezuar me emrin e Atit e Birit edhe Shpirtit Shenjt, edhe dyke i mesuar te rúajnë te gjitha ató, qe ju porrosita. Dhe ja, unc do te jem bashkë me ju gjithë ditet gjer ne mbarimin e jetes. Amín.

KORI: Lavdí më ty, o Zot, lavdí më ty.

Pastáj Prifti e sperkát te pagezúarin me uje te pagme, merr nje sfyngjér te ri me uje, dhe ia fshin fytyren, krahherorin, dúarte dhe kembet, dyke thene:

PRIFTI: U-pagezove, u-ndriçove, u-mirose, u-shenjterove, u-çperlave, më emrin e Atit e Birit edhe Shpirtit Shenjt, taní e perherc dhe nc jetet e jéteve. Amín.

Pastáj Prifti i pret floket te pagezúarit kryqthi me gershëre, dyke thene:

PRIFTI: Qethet sherbетори i Perendise (*aksh*), më emrin e Atit e Birit edhe Shpirtit Shenjt. Amín.

Pastáj Prifti e kungón te pagezúarin, dyke thene:

PRIFTI: Kungohet sherbетори i Perendise (*aksh*) me Trupin dhe me Gjakun e çemuar te Zottit edhe Perendise dhe Shpetimtarit tone Jesú Krisht per ndjesen e mëkâtave dhe për jetën e ameshuar.

KORI: Kungoni Trupin e Krishtit; ngjeroni burimin e pavdekur. Alilluja, alilluja, alilluja.

PRIFTI: Lavdí më ty, o Perëndia ync, lavdí më ty.

KORI: Lavdí Atit e Birit edhe Shpirtit Shenjt, taní e perherc dhe nc jetet e jéteve. Amín. Meshiró, o Zot (*3 here*). Bekó, o Atc.

Pastáj Prifti ben Perleshimin:

PRIFTI: Krishti, Perëndia ync i vërtete, që u-

pagezua nc Jordán, me nërmjetimet e Shen Marise; te Shen Joán Pagezorit; te Shenjtit te Kishes (*aksh*); te Shenjtit te dites (*aksh*), te cilin po lusim sot; edhe te gjithë Shenjtoreve; na meshiroftë, dhe na shpetofte si i mirë dhe njeridashës.

KORI: Amín.